

## APLIKIMI PER LICENSE

Ka te drejte te aplikojte per nje license te leshuar nga ERE, çdo person qe ka vendqendrimin e tij ne Shqiperi, dhe me objekt te veprimtarise aktivitetin e kerkuar per licensim. Çdo person i huaj duhet te krijojte nje shoqeri sipas legjislacionit ne fuqi, me objekt veprimtarie aktivitetin e kerkuar per licensim nga ERE per te gjithe periudhen e vlefshmerise se licenses.

## PERGATITJA E DOSJES SE APLIKIMIT

- Aplikimi konsiston ne formatin e aplikimit dhe dokumentacionin perkates
- Aplikuesi do te kryej pagesen per aplikim ne momentin e paraqitjes se aplikimit sic percaktohet ne tabelen e meposteme

<b>AKTIVITETI</b>	<b>LICENSIM</b>	<b>MODIFIKIMI</b>	<b>RINOVIM</b>	<b>TRANSFERIM</b>
Prodhimin e energjise elektrike;	10 000 Leke/MW	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke
Transmetimin e energjise elektrike;	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke
Shperndarjen e energjise elektrike;	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke
Furnizimin Publik me Shumice te energjise elektrike;	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke
Furnizimin Publik me Pakice te energjise elektrike	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke
Furnizimin me energji elektrike te klienteve te kualifikuar	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke
Tregtimin e energjise elektrike	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke	10 000 Leke

- Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet te jete ne gjuhen shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar ndersa vertetimet dhe deklaratat nga organe e tjera duhet te jene leshuar jo me pare se 3 muaj nga momenti i paraqitjes se aplikimit.
- Nese aplikuesi ka aplikuar dhe eshte ne proces per marrjen e lejeve te tjera te nevojshme te percaktuara ne rregullore, mund te paraqese aplikimin ne ERE duke paraqitur informacion nga institucioni perkates per fazen ne te cilen ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.

- Dokumentacioni teknik sipas tipit te licenses duhet te jete i hartuar dhe sigluar nga eksperte te licensuar (ing. elektrike, ing. mekanike, eksperte kontabel, ing. hidroteknike etj.)
- Cdo aplikim i shoqeruar me dokumentacionin perkates do te paraqitet ne dy kopje: nje origjinale ose fotokopje e noterizuar sic percaktohet ne piken 3 dhe nje kopje fotokopje e te gjitha dokumentacionit sic percaktohet nga kjo rregullore.
- Per centralet te cilat perdorin energjine valore te detit dhe/ose energjine e baticave dhe zbaticave paraqiten te njejtat dokumenta te aplikueshme si per HEC dhe ne perputhje me kuadrin ligjor.

ERE leshon tipet e licensave dhe me afat vlefshmerie sic percaktohet me poshte:

- Prodhimin e energjise elektrike me afat deri 30 vjet;
- Transmetimin e energjise elektrike me afat deri 25 vjet;
- Shperndarjen e energjise elektrike me afat deri 30 vjet;
- Furnizimin Publik me Shumice te energjise elektrike me afat deri 5 vjet;
- Furnizimin Publik me Pakice te energjise elektrike me afat deri 5 vjet;
- Furnizimin me energji elektrike te klienteve te kualifikuar me afat deri 5 vjet;
- Tregtimin e energjise elektrike me afat deri 5 vjet;

Per shoqerite te cilat jane te licensuar ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike dhe kerkojne te licensohen ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike kohezgjatje e vlefshmerise se licenses se tregtimit te energjise elektrike do te percaktohet ne perputhje me ate te licenses se prodhimit te energjise elektrike

[Per me teper shihni rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit te plote/pjesshem dhe rinovimit te licensave.](#)